



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHË  
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË ✓

Nr. 2812 Prot

Lezhë, më 02 / 03 /2026

VENDIM

Nr. 22, Datë 25. 02. 2026

**PËR VËNIEN NË DISPOZICION DHE KALIMIN NË PRONËSI TË NJË  
APARTAMENTI NË FAVOR TË FAMILJES PËRFITUESE, NË KUADËR TË  
PROCESIT TË RINDËRTIMIT**

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, të nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja "b", nenit 29, pika 1, nenit 54, nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, ligjit nr. 45/2019, "Për mbrojtjen civile", Aktit Normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, vendimit nr. 5, datë 6.1.2020, të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model", të ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Bashkisë Lezhë nr.17, datë 03.02.2021 "Për miratimin e listës së subjekteve përfituese për grante rindërtimi për shtëpitë individuale dhe banesa në ndërtesa (Pallate) me shkallë dëmtimi DS4 dhe DS5 sipas analizave të thelluara të Institutit të Ndërtimit në Bashkinë Lezhë", shkresën nr. 555 prot, datë 24.02.2021, nga Enti Kombëtar i Banesave; me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë;

**Vendosi:**

1. Revokimin e masës së përfitimit në vlerë monetare e qytetarit Gjon Ndrec Ndreca si subjekt përfitues i grantit të rindërtimit që ka zgjedhur ta ndërtojë vetë banesën dhe amendimin e Vendimit nr 80 datë 19.04.2021 të Këshillit Bashkisë Lezhë për "Përcaktimin e struktureve të banimit dhe masës së përfitimit në vlerë monetare për subjektet përfituese të grantit të rindërtimit të cilët kanë zgjedhur që ndërtimin e banesave ta bëjnë vetë", Aneks nr.1; eliminimin e nr rendor 5;
2. Miratimin, vënien në dispozicion dhe kalimi në pronësi, pa shpërblim, të apartamentit nr. 11, kati 4, me sipërfaqe 111 m<sup>2</sup> me strukturë 2+1, ndodhur në Lagjen Beslidhja, në favor të familjes së z. Gjon Ndrec Ndreca, shpallur përfitues bazuar në Vendimin e Këshillit të Bashkisë Lezhë Nr.17, datë 03.02.2021 për "Miratimin e listës së subjekteve përfituese për grante rindërtimi për shtëpitë individuale dhe banesa në ndërtesa (pallate) me shkallë dëmtimi DS4 dhe DS5 sipas analizave të thelluara të Institutit të Ndërtimit në Bashkinë Lezhë, që është pjesë e pasurisë së dhuruar nga Enti Kombëtar i Banesave në favor të

Bashkisë Lezhë, sipas shkresës nr. 555 prot, datë 24.02.2021, nga Enti Kombëtar i Banesave;

3. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë Lezhë për:
  - a. Hartimin e kontratës së kalimit të pronësisë;
  - b. Kryerjen e procedurave të regjistrimit pranë ASHK;
  - c. Ndjekjen e dorëzimit fizik të banesës;
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar.

**SEKRETARI**  
**FLORIDA ÇUNAJ**



**KRYETARI**  
**NDUE LULI**

